



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 26 prill 2012  
Nr. ref.: RK225/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI153/11**

Parashtruesja

**Fazilja Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr.  
564/2011, të 5 gushtit 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

## **Parashtruesja e kërkesës**

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fazilja Berisha, të cilën e përfaqëson i biri i saj, z. Ramadan Berisha, nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 564/2011, të 5 gushtit 2011, i cili nuk dihet se kur iu dorëzua parashtrueses së kërkesës.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të Aktgjykimit A. nr. 564/2011 të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe atë nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 51 [Mbrojtja sociale dhe shëndetësore].

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 30 nëntor 2011, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 17 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 153/11 emëroi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI 153/11, emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
7. Më 3 shkurt 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të njoftojë Gjykatën se kur i ishte dorëzuar Aktgjykimi A. nr. 564/2011 i 5 gushtit 2011 i Gjykatës Supreme, dhe që të dorëzonte vendimin Nr. 5066727 të datës 20 prill 2011 të Këshillit për Ankesa. Deri më tani nuk është pranuar asnjë përgjigje.
8. Më 6 shkurt 2012, Gjykata i njoftoi për kërkesën Gjykatën Supreme dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Këshillin për Ankesa (në tekstin e mëtejme: Këshilli për Ankesa).
9. Më 19 prill 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 19 janar 2011, Komisioni Mjekësor, i themeluar për përcaktimin e të drejtës mjekësore për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar, në bazë të gjetjeve dhe mendimit të komisionit mjekësor të gjykatës së shkallës së parë të 6 dhjetorit 2010, me çka vlerësohet se parashtruesja e kërkesës nuk shfaqte paaftësi të përhershme për të punuar siç parashihet me nenin 3 [Kriteret për përcaktimin e Aftësisë së kufizuar] të Ligjit Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë

(Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale.

11. Më 7 mars 2011, Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe mbështeti vendimin e Komisionit Mjekësor (Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi në Këshillin e Ankesave.
12. Më 20 prill 2011, Këshilli i Ankesave refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë dhe mbështeti vendimin e Departamentit të Administratës Pensionale (Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës inicioi kontest administrativ në Gjykatën Supreme.
13. Më 5 gusht 2011, Gjykata Supreme refuzoi ankesën si të pabazë. Gjykata Supreme konstatoi se dëshmitë tregonin se parashtruesja e kërkesës nuk i plotësonte kriteret ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar për pension të aftësisë së kufizuar (Aktgjykimi A. nr. 564/2011).

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

14. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme “*nuk i ka ekzaminuar si duhet faktet dhe se Gjykata Supreme nuk ka kryer fare ekzaminim të dëshmiave fizike, nuk na ka ftuar në seancë si paditës dhe se aktgjykimi është i bazuar vetëm në dosjen e lëndës*”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

15. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 51 [Mbrotjtja sociale dhe shëndetësore] të Kushtetutës. Gjykata rikujton se, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.
16. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk është për të vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
17. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesja e kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, për shembull, Raporti i Komisionit Evr. për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87 të miratuar më 10 korrik 1991).
18. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në mënyrë të rregullt ligjin e aplikueshëm dhe shpreh mospajtimin me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e saj.

19. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata të rregullta si tërësi, Gjkata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta o të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis* Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
20. Nga kjo del se, kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhshmëri me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës i cili parasheh: “Gjkata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.”
21. Prandaj rezulton që kërkesa është e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, më 19 prill 2012, njëzëri,

### **VENDOSI**


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani